

Të nderuar deputetë të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave,

Raporti “Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2013” është përgatitur në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 164, pika 1, germat a-b; ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr.8599, datë 1/6/2000, neni 18, pika 1, gërmat a-b dhe të ligjit nr. 9936, datë 26/6/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 62 e 63; si dhe të ligjit nr. 119/2012 , “Për Buxhetin e vitit 2013”, i ndryshuar.

KLSH në funksion të përmbushjes së detyrimit kushtetues dhe ligjor ka orientuar veprimtarinë e tij audituese në konvergjencë dhe në zbatim të plotë të direktivës kryesore të shprehur në Kongresin e XXI të INTOSAI, **“Auditimi kombëtar të vihet në shërbim të qeverisjes kombëtare, për përmirësimin e menaxhimit publik financiar të vendit”**.

Opinionin ynë i përgjithshëm

Mbi bazën e 124 auditimeve të kryera nga KLSH për buxhetin faktik të vitit 2013, ne institucione të qeverisjes qendrore (ministri, ente të tjera qendrore, shoqëri aksionere, projekte me financime të huaja, etj), si dhe në njësi të qeverisjes vendore, kombinuar me vlerësimin e sistemeve të menaxhimit financiar, kontrollit dhe auditimit të brendshëm, si dhe vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve tona gjatë auditimit të zbatimit të Buxhetit për vitin 2012, **opinionin ynë i përgjithshëm**, në përputhje të plotë me Standardin ISSAI 1700 të auditimit suprem, për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2013, para miratimit të tij nga Kuvendi i Shqipërisë, është se **përgatitja, shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit të vitit 2013, zbatimi, ndjekja dhe rishikimi i tij, të drejtat dhe kufizimet për huamarrjen, garancitë dhe format e tjera të rrjedhura prej tyre si dhe kontrolli, kontabiliteti, raportimi dhe auditimi i këtij buxheti, janë kryer në respektim të kërkesave të ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; të ligjit “Për buxhetin e Shtetit të vitit 2013”, të ndryshuar, si dhe të ligjit “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”**.

Duke patur parasysh mjedisin e vështirë në të cilin u realizua Buxheti i vitit 2013, **KLSH, vlerëson pozitivisht punën e bërë nga Qeveria, Ministria e Financave, Ministrinë, Institucionet e tjera qendrore dhe vendore, si dhe entet publike të audituara, përgjatë vitit 2013 në drejtim të adresimit dhe konsolidimit të mëtejshëm të reformave drejt një menaxhimi sa më efektiv të financave publike si dhe përpjekjet për përmirësimin e kuadrit rregullator me synim orientimin drejt objektivit themelor të përafrimit të legjislacionit shqiptar me direktivat e BE si një nga prioritetet kyçe të rrugës së nisur drejt integritetit evropian**.

Mbi bazën e të dhënave të realizimit të treguesve makroekonomike të vitit 2013 dhe nga analizimi i tyre, konkludojmë se ekonomia shqiptare ka arritur të përballojë efektet e krizës ekonomike dhe financiare të Eurozonës, por pa ruajtur tërësisht ekuilibrat kryesorë

makroekonomikë. *KLSH nëpërmjet këtij raporti sjell në vëmendje të Kuvendit disa prej rekomandimeve kryesore të cilat synojnë përmirësimin e kuadrit rregullator dhe reflektojnë praktikën më të mirë të standarteve ndërkombëtare në menaxhimin e finacave publike.*

Buxheti i shtetit për vitin 2013, është bazuar në aktet e mëposhtme ligjore:

1. Ligji nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”.
2. Ligji nr. 166/2013 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 6, datë 4.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 119/2012 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2013”.
3. Ligji nr.1/2014 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 7, datë 14.12.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 119/2012 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2013”, të ndryshuar.

Realizimi i treguesve të konsoliduar fiskalë të Buxhetit të Shtetit për vitin 2013 paraqitet si vijon:

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit të shtetit rezultuan në 24.1 % të PBB-së kundrejt 24. % të PBB-se të planifikuara duke reflektuar një tejkalim të lehtë prej 0.1 % të PBB-së. Të ardhurat janë realizuar, rreth 327.18 miliardë lekë nga 325.92 miliardë lekë të planifikuara, me një tejkalim prej 1.26 miliardë lekë në të ardhurat e përgjithshme buxhetore.

Për vitin 2013, **shpenzimet e përgjithshme të buxhetit të shtetit** përfaqësonin 29 % të PBB-së dhe në terma nominalë shpenzimet e përgjithshme rezultuan 394 118 milionë lekë kundrejt 409 408 milionë lekë që ishte niveli i planifikuar i shpenzimeve duke reflektuar një mosshpenzim të fondeve buxhetore në rreth 15.2 miliardë lekë.

Duke i analizuar nga pikëpamja strukturore sipas dy kategorive kryesore shpenzimet korrente dhe kapitale, konstatohet se shpenzimet korrente për vitin 2013 janë realizuar në vlerën 328,461 milionë lekëve, kundrejt nivelit të planifikuar prej 331,004 milionë lekë, me një mosshpenzim prej rreth 2.4 miliardë lekë.

Gjithashtu, konstatohet se **shpenzimet korrente janë realizuar në një përqindje më të madhe se sa niveli i realizimit të shpenzimeve kapitale, respektivisht 99.3% dhe 83.7 %** . Në krahasim me një vit më parë rezulton se fondet e shpenzuara në zërin “Shpenzime korrente” në vitin 2013, paraqiten me rritje në krahasim me një vit më parë, me 4.47 %, nga 314,585 milionë lekë në vitin 2012, në 328,641 milionë lekë në vitin 2013, ndërkohë që edhe fondet e përdorura për shpenzimet kapitale në vitin 2013 kundrejt vitit 2012, paraqiten me rritje, por në masën 6.2 %, nga 61,656 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2012, në 65,479 milionë lekë në vitin 2013.

Analizuar sipas zërave të shpenzimeve korrente, rezulton se:

1. *Shpenzimet për personelin për vitin 2013 zënë rreth 5.2% të PBB-së pra janë në një nivel me vitin 2012, 5.2 % PBB-së. Shpenzimet për personelin përfaqësojnë 21.52 % të shpenzimeve*

korrente dhe janë realizuar në vlerën 70,716 milionë lekë kundrejt 71,538 milionë lekë të planifikuar.

2. *Shpenzimet operative mirëmbajtje për vitin 2013*, përfaqësojnë 2.4 % të PBB-së dhe përfaqësojnë të njëjtin nivel ndaj PBB-së si dhe për vitin 2012. Shpenzimet operative dhe mirëmbajtjes zënë 9.9 % të shpenzimeve korrente dhe janë realizuar në vlerën 32,424 milionë lekë kundrejt 34,035 milionë lekë të planifikuar.

3. *Shpenzimet për interesat për vitin 2013*, përfaqësojnë 3.2 % të PBB-së dhe paraqiten me një rritje të lehtë kundrejt nivelit 3.1% të PBB-së të vitit 2012 . Shpenzimet për interesa zënë 13.2 % të shpenzimeve korrente dhe janë realizuar në vlerën 43,336 milionë lekë kundrejt 43,900 milionë lekë të planifikuar.

4. *Shpenzimet për subvencione*, zënë rreth 0.48% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2013, nga 0.6 % që zinin një vit më parë. Kundrejt kuotës së planifikuar, ato janë realizuar në masën 100.3 % ose nga 1,569 milionë lekë në 1,574 milionë lekë. Shpenzimet për subvencion qëndrojnë në të njëjtin nivel kundrejt PBB (rreth 0.1%) si për vitin 2013 ashtu dhe për vitin 2012.

5. *Shpenzimet për fonde speciale (sigurimet shoqërore, shëndetësore, politika të reja pensionesh dhe fondi i kompensimit në vlerë të pronarëve)*, paraqiten me një rritje prej rreth 0.4 % kundrejt vitit 2012. Shpenzimet për fondet speciale zënë 38.8 % të shpenzimeve korrente dhe janë realizuar në vlerën 127,643 milionë lekë kundrejt 128,120 milionë lekë të planifikuar.

6. *Shpenzimet për buxhetin vendor* përfaqësojnë 2.2 % të PBB-së për vitin 2013 dhe paraqiten me një rritje kundrejt vitit 2012, që përfaqësonin 2.1% të PBB-së. Shpenzimet për Buxhetin vendor zënë 9.1 % të shpenzimeve korrente dhe janë realizuar në vlerën 29,787 milionë lekë kundrejt 28,580 milionë lekë të planifikuar, ose 104.2 %.

7. *Shpenzime të tjera sociale (pagesa e papunësisë, ndihma ekonomike dhe fondi i kompensimit për ish të përndjekurit politikë)* zënë 7.1 % të shpenzimeve korrente dhe janë realizuar në vlerën 23,161 milionë lekë kundrejt 223,262 milionë lekë të planifikuar, ose 99.6 %.

Në strukturë, shpenzimet për pagesën e papunësisë, ndihmën ekonomike dhe fondin e kompensimit për ish të përndjekurit politikë janë realizuar respektivisht 93 %, 99.8% dhe 99.7%, dhe në vlerë përkatësisht 800 milionë lekë, 19,370 milionë lekë dhe 2,991 milionë lekë.

Shpenzimet kapitale (me financim të brendshëm dhe të huaj), zënë rreth 16.61% të totalit të përgjithshëm të shpenzimeve të realizuara në vitin 2013, nga 16.39 % që zinin në vitin 2012. Në strukturë, shpenzimet kapitale me financim të brendshëm janë realizuar në masën 97.9 %, ndërsa ato me financim të huaj janë realizuar në masën 72.1%.

Krahasuar me vitin 2012, ka një rritje të fondeve të shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, konkretisht me 9,303 milionë lekë më shumë, nga 27,398 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2012, në 36,701 të shpenzuara atë vitit 2013. Për financimin e huaj konstatohet një ulje e shpenzimeve kapitale nga nga 34,257 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2012, në 28,776 milionë lekë të shpenzuar në vitin 2013, pra me një rënie në vlerë prej 5,481 milionë lekë.

Kundrejt PBB-së të vitit 2013, shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj zënë përkatësisht 2.7% dhe 2.1%, nga 2.1% dhe 2.6% të PBB-së të rezultuar në vitin 2012.

Deficiti i përgjithshëm i buxhetit për vitin 2013 përfaqëson 4.9% të PBB-së kundrejt 3.5% të PBB-së që përfaqësonte në vitin 2012. Deficiti në fund të vitit 2013 rezultoi në vlerën 70,413 milionë lekë nga 83,490 milionë lekë të programuara me ndryshime.

Borxhit Publik për vitin 2013, rezultoi në vlerën 885,083 milionë lekë ose 65.18% të PBB-së kundrejt 828,275 milionë lekë në vitin 2012 dhe që përfaqësonte 61.53 % të PBB-së. Borxhi Publik përbëhet nga:

A. *Borxhi publik i qeverisjes qendrore*, rezultoi në vlerën 884,692 milionë lekë, nga 827,981 milionë lekë që rezultoi në fund të vitit 2012, ose e shprehur në përqindje kundrejt PBB-së rezultoi përkatësisht 65.15 % nga 62.44 % që rezultoi në fund të vitit 2012 pra me një rritje prej 2.71 % të PBB-se. Ky borxh i rezultuar në vitin 2013, përbëhet nga:

- *Borxhi i brendshëm*, i cili rezulton në vlerën 520,786 milionë lekë ose 38,35 % të PBB-së, nga 470,359 milionë lekë ose 35.47 % të PBB-së që rezultoi në vitin 2012 ose me një rritje prej 2.88 % të PBB-së .
- *Borxhi i jashtëm*, i cili rezulton 363,906 milionë lekë ose 26,8 % të PBB-së nga 357,622 milionë lekë ose 26.97% të PBB-së duke reflektuar një ulje të lehtë ndaj vitit të kaluar prej 0.17 % të PBB-së.

B. *Borxhi i qeverisjes vendore* në vitin 2013, **rezultoi 390,9 milionë lekë ose 0.028 % e GDP**, nga 288 milionë lekë ose 0.021% të PBB-së që rezultoi në vitin 2012.

Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) si një nga treguesit kryesorë (me çmimet korrente) bazuar në evidencat e Ministrisë së Financave ka arritur në kuotën e 1,358,000 milionë lekë.

KLSH nëpërmjet këtij raporti sjell në vëmendje të Kuvendit disa prej rekomandimeve kryesore të cilat synojnë përmirësimin e kuadrit rregullator dhe reflektojnë praktikën më të mirë të standarteve ndërkombëtare në menaxhimin e financave publike.

1. Në drejtim të marrjes së masave për sigurimin e qëndrueshmërisë, kredibilitetit të financave publike dhe konsolidimin e një kuadri, rregulli fiskal si dhe me synim:
Promovimin e një qëndrueshmërie dhe kredibiliteti të financave publike;
Vlerësimin e planifikimit dhe performancës fiskale, të projeksioneve makroekonomike dhe parashikimeve buxhetore

Kemi rekomanduar:

- Ministria e Financave të ndërmarrë nismën ligjore për ngritjen e një Këshilli Fiskal, pasi në gjykimin tonë, vende si i yni kanë nevojë për opoenca të politikave fiskale, që të jenë thellësisht teknike dhe të pavarura.
- Ministria e Financave të ndërmarrë të gjitha masat për hartimin e një kuadri rregullator fiskal, i cili të synojë reduktimin e nivelit të borxhit publik në një periudhë të përcaktuar kohore dhe sigurimin e një qëndrueshmërie afatgjatë të borxhit publik si dhe
- Përgatitjen dhe paraqitjen e një iniciative ligjore për vendosjen në Kushtetutë dhe në Ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të indikatorit të borxhit publik ndaj PBB-së, në nivelin tavan 60 % dhe arritjen e këtij niveli në terma afat afatgjatë.

2. Në drejtim të fuqizimit të ligjit “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, nisur nga konstatimi që ligji bazë themeltar për menaxhimin e financave publike në vend “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, rezulton me një rezistencë të ulët, pra është lehtësisht i thyeshëm nga pikëpamja e vendimmarrjes parlamentare,
Kemi rekomanduar:

- *Shqyrtimi i ndryshimeve të parashikuara në Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020 të ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe miratimi i tij në Kuvend të bëhet me një shumicë të cilësuar parlamentare.*

3. Në funksion të hartimit të një strategjie efektive të menaxhimit të financave publike si dhe me synim arritjen e pritshmërive të projektuara, bazuar në shtyllat kryesore që kanë të bëjnë me:

- Hartimin e një kuadri të fiskal të qëndrueshëm e realist,
- Planifikimin e buxhetimit e integruar dhe eficient të shpenzimeve publike,
- Rritjen e përgjegjshmërisë në nivel menaxherial,
- Përmirësimin dhe rritjen e transparencës së raportimit financiar të qeverisë
- Forcimin e kontrollit të brendshëm në sektorin publik,
- Mbikqyrjen efektive parlamentare

Kemi rekomanduar:

- *Gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e KLSH-së, të jenë pjesë përbërëse dhe të skedulohen në Planin e Veprimit dhe në aktivitet kyçe që do të ndërmerren në kuadrin e implementimit të strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020. Grupi i punës i ngritur në kuadrin e bashkërendimit, hartimit dhe ndjekjes së zbatimit të strategjisë me synim përmbushjen e objektivit për rishikimin e kuadrit rregullator ligjor të Menaxhimit të Financave Publike të shqyrtoje analizoje, adresojë dhe integroje rekomandimet e KLSH në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020.*

4. Në funksion të një menaxhimi efektiv të borxhit publik i kemi adresuar një sërë rekomandimesh Ministrisë së Financave. Kështu:

a. Me synim një menaxhim efektiv të borxhit publik, kemi rekomanduar që:

- Të punohet për të patur një menaxhim të borxhit publik në kordinim të plotë me Politikën Makroekonomike. Politikën fiskale deri vjet kishin për qëllim që të mbanin kufirin e borxhit nën kontroll, por për sa kohë ky kufi nuk është më një detyrim ligjor i fiksuar, risku i mungesës së kordinimit midis menaxhimit të borxhit publik me politikën fiskale do të jetë në rritje.
- Kemi kërkuar po ashtu një kordinim më të mirë me politikën monetare, ose saktësime ligjore në Marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, të cilat lidhen me kreditimin afatshkurtër.
- Në kuadër të mirëorganizimit të proceseve që lidhen me menaxhimin e borxhit publik, cilësojmë nevojën për një Manual të Borxhit Publik, ku në referencë të standardeve dhe praktikave më të mira, të përcaktohet metodologjia për parashikimin, zhvillimin e aktivitetit të huamarrjes, të shërbimit, monitorimit dhe raportimit të borxhit, procedurat dhe teknikat për

vlërësimin e risqeve si dhe treguesit e matjes së përformacës së veprimtarisë së huamarrjes publike.

- Referuar faktit që Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave, analizojnë në mënyrë të ndryshme borxhin e jashtëm (megjithëse të dhënat janë ato të Ministrisë së Financave) e gjykojmë të nevojshme që të ketë një Marreveshje për mënyrën e raportimit të borxhit të jashtëm, në mënyrë që të ketë të paktën krahasueshmëri të pjesshme në analizat e dy institucioneve.
- Nisur nga konstatimi se Drejtorisë së Menaxhimit të Borxhit Publik i është pakësuar ndjeshëm numri i punonjësve të saj, e pa shoqëruar kjo ulje me ndonjë përmirësim të infrastrukturës së informacionit, gjë që e ka ekspozuar këtë funksion ndaj një risku të lartë lidhur me sigurinë dhe saktësinë e deklarimit të të dhënave mbi borxhin, **kemi rekomanduar që të kthehen strukturat në gjëndjen e mëparshme.** Të merren masa për të siguruar përpunimin e informatizuar të të gjithë të dhënave të borxhit publik. Të punohet për ngritjen e kapaciteteve të kësaj strukture me rëndësi në menaxhimin e financave publike, me trajnime e kualifikime të vazhdueshme.

b. Mbi përcaktimin ligjor për dhënien e garancive shtetërore mbi stokun e përcaktuar me ligj

- Kemi kërkuar që në ligjet vjetore të buxhetit të *mos vendosen përcaktime të cilat i adresojnë* Këshillit të Ministrave të drejtën për rritjen e stokut të borxhit përtej limiteve të përcaktuara me ligj.

c. Në drejtim të saktësisë së evidentimit të shpenzimeve kapitale me financim të huaj, kemi rekomanduar:

- Ministria e Financave t'u tërheqë vëmendjen njësive të zbatimit të projekteve dhe të procedojë me masat përkatëse administrative në përputhje me ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, jo vetëm për vonesat në raportime, por edhe për rregullshmërinë e tyre.

5. Me synim përdorimin efektiv të fondit rezervë të Këshillit të Ministrave dhe të fondit kontigjencë dhe mos përsëritjes së problematikave lidhur me mungesa në dokumentacion, në relacionet shpjegues dhe në preventiva shpenzimesh, apo në trajtimin e tij si shtesë buxheti për institucionet përfituese,

Kemi rekomanduar

- Në Ligjin Organik të Buxhetit që do të rishikohet, të përcaktohet që Vendimet e Këshillit të Ministrave për përdorimin e fondit rezervë të Buxhetit të Shtetit, të merren pas miratimit paraprak me shkrim i Ministrit të Financave, duke shmangur në këtë mënyrë përdorimin e këtyre fondeve nga institucionet përfituese pa relacion shpjegues, pa preventiv shpenzimesh, apo përdorimin e këtyre fondeve si “shtesë buxheti”.
- Të përcaktohen në ligjin vjetor të buxhetit drejtimet e përdorimit të Fondit të Kontigjencës, i cili është fond i pashpërndarë, që krijohet për të mbuluar risqet e mundshme për të ardhurat dhe shpenzimet gjatë zbatimit të buxhetit. Në këtë ligj duhet të përcaktohet sasia e fondit përkatës sipas tre drejtimeve: **për të përballuar efektet e mosrealizimit të ardhurave, për financime të reja dhe për shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara të programeve ekzistuese.**

6. Në drejtim të përdorimit të të ardhurave nga privatizimi për uljen e borxhit publik, për investime kapitale dhe dëmshpërblimin e ish të përndjekurve politikë,

Kemi rekomanduar:

- Në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të përcaktohet që të ardhurat nga privatizimet duhet të përdoren së pari dhe kryesisht për të ulur borxhin publik, ku 50% të jetë kufiri i poshtëm, dhe pjesa tjetër prej 30 % të përdoret për financimin e investimeve kapitale si dhe 20% për dëmshpërblimin ligjor të ish të përndjekurve politikë.

7. Në drejtim të përgatitjes së pasqyrave të konsoliduara financiare të shtetit, referuar faktit që problematika e mungesës së pasqyrave financiare të konsoliduara të shtetit, vazhdon edhe në këtë vit, pra Ministria e Financës nuk arritur të nxjerrë përmbledhësen e llogarive të konsoliduara vjetore, por vetëm mbylljen e llogarive vjetore të buxhetit të vitit 2013, **kemi theksuar:**

- Domosdoshmërinë e ndërhyrjeve të menjëhershme për hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara të shtetit, si dhe ndërmarrjen e veprime konkrete për hartimin e një kuadri të plotë rregullator të kontabilitetit dhe raportimit financiar në sektorin publik.

8. Në drejtim të hartimit dhe forcimit të një kuadri rregullator “Për përgjegjësinë materiale” nisur nga faktet se:

1. KLSH ka konstatuar mjaft probleme dhe shkelje të dispozitave ligjore në fonde të konsiderueshme publike, që kanë sjellë harxhimin e tyre pa kriter dhe efikasitet, ose edhe më keq, shkuarjen dëm të një pjese të tyre, nga keqmenaxhimi financiar.
2. Keqpërdorimi i fondeve publike dhe përgjegjësitë materiale të nëpunësve publikë që kanë kontribuar në këto, dënohen kryesisht me sanksione administrative
3. Vendimarrjet e gabuara në administrimin e pronës shtetërore, me pasoja ekonomike të konsiderueshme po kthehen në një fenomen normal të aktivitetit të administratës publike.
4. Pamundësisë sonë për të adresuar qartësisht shpërblimin e këtyre dëmeve nga personat përgjegjës

Kemi rekomanduar

Ministria e Financave të ngrejë një grup pune për hartimin e një ligjit “Mbi përgjegjësinë materiale” në të cilën të trajtohet përgjegjësia financiare e punonjësve të njësive publike (zyrtarët e lartë dhe punonjësit e të gjithë niveleve) për dëmet ekonomike të shkaktuara qëllimisht apo nga neglizhenca, gjatë ose në lidhje me procesin e ekzekutimit të detyrave zyrtar

9. Në drejtim të vlerësimit të funksionimit të menaxhimit financiar e kontrollit dhe performancën e auditimit të brendshëm.

« Auditimi i brendshëm dhe ai i jashtëm publik luajnë një rol kyç në mekanizmin e mbrojtjes së financave publike. Ata kanë objektiv të përgjithshëm të njëjtte-Menaxhimin e shëndoshë të financave publike, por ndryshojnë në qëllimet e auditimit, në menyren e funksionimit dhe në raportimin » (marrë nga fjala e z. Robert Gielisse, keshilltar kryesor i Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorise së Buxhetit në BE).

Duke qënë të bindur se auditimi i brendshëm publik ka një rol të rëndësishëm për një sistem të shëndetshëm në menaxhimin e financave publike, vlerësimi i veprimtarisë së strukturave të auditimit të brendshëm në sektorin publik ka qënë një nga objektivat kryesore të veprimtarisë së KLSH.

- Kemi konstatuar se sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 179, datë 18.10.2013 “Për miratimin e Strukturës dhe organikës së Ministrisë së Financave”, është ndryshuar varësia dhe struktura e Njesisë, duke u organizuar në nivel Drejtorie në vartësi të Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Kontrolluese.

- Është pakësuar me mbi 3 herë numri i punonjësve, dhe kjo, pa ndonjë analizë të thelluar për veprimtarinë e kësaj njësie dhe pa marrë parasysh detyrimet që rrjedhin nga ligji, duke rrezikuar realizimin e funksioneve në mënyrë efektive.

- Kemi konstatuar proces planifikimi me elementë të theksuar formaliteti, i cili miratohet në procedura formale nga një strukturë jo e përshtatshme lidhur me funksionin dhe detyrimet që i jep ligji, përfshirjen e audituesve në auditime tematike jashtë planeve vjetore, si dhe problematika të planifikimit të burimeve njerëzore dhe kostove për auditues.

Në kuadrin e përmirësimeve ligjore që aktualisht po ndërmerr Ministria e Financave, mendojmë se duhet të synohet në radhë të parë konsolidimi i pavarësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Kemi rekomanduar:

1. Një Komitet Auditimi (jo më shumë se 5 vetë me kohë të plotë), në varësi të dyfishtë nga Kryeministri dhe Ministri i Financave, i cili do të siguronte një nivel pavarësie që do të plotësonte objektivat e këtij funksioni. Me këto ndryshime të synohet pavarësia e Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, duke përcaktuar me kujdes varësinë, strukturën dhe përzgjedhjen e stafit në mënyrë të tillë që të jenë në funksion të realizimit sa më të efektshëm të funksioneve harmonizuese, monitoruese, vlerësuese të cilësisë dhe asistencës teknike për të gjitha strukturat e auditit të brendshëm. Edhe në këtë rast, sugjerojmë varësi dyfishe nga Komiteti i Auditimit dhe Ministri i Financave.

- Duke vlerësuar se përmirësimet ligjore duhet të jenë procese të cilat paraprihen nga një skanim i plotë i situatës dhe zonave me risk real, diskutime të gjëra me ekspertë të brendshëm dhe të huaj, **kemi rekomanduar** që ndërhyrjet të ndërmerren të menduara, në drejtim të saktësisë të funksioneve të çdo pjesëmarrësi (Ministri i Financave, Komiteti i Auditimit, Njësia Qendrore e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm) dhe rolit të tyre në forcimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik.

- Duke ju referuar faktit që bordet dhe komisionet part-time nuk kanë rezultuar funksionale në kontekstin e vendit, gjuajmë që **Komiteti i Auditimit, si një instrument i rëndësishëm në monitorimin dhe mbikëqyrjen e auditimit të brendshëm në sektorin publik të jetë një komitet me kohë të plotë, duke sanksionuar kështu edhe predispozicionin për të rritur rolin e strukturave të auditimit të brendshëm në mirëqeverisjen e fondeve publike.**

Theksojmë se bazuar në formalitetin e konstatuar në rolin e komiteve të deritanishme, gjuajmë se në kontekstin shqiptar duhet të hiqet dorë nga struktura që shpenzojnë paratë e taksapaguesve me nivel të ulët përgjegjëshmërie dhe përgjegjësie.

2. Kemi konstatuar se Manuali i Auditimit nuk ka përcaktim për auditimet e plota, duke sjellë problematikën e mos përcaktimit të saktë mbi llojet e auditimeve që do të planifikohen dhe

raportohen si auditime të plota. Raportet e Veprimtarisë të NJAB dhe Raporti Përmbledhës i Konsoliduar, nuk evidentojnë se sa nga vlera e gjetjeve me ndikim financiar është ngarkuar për çdëmtim.

Kemi rekomanduar që:

- Të punohet për rishikimin e plotë të Manualit të Auditimit, për t'i dhënë plotësinë si në parime dhe në metodologjitë e planifikimit dhe vlerësimit të riskut, në formate raportimi që do të mundësonin lexim të njëjtë të gjetjeve dhe konstatimeve pavarësisht në cilën strukturë raportohen.

- Manuali duhet të plotësohet me elementët bazë të parandalimit dhe zbulimit të skemave të mashtrimit nga audituesit e brendshëm.

3. Duke u nisur nga problematika e konstatuar lidhur me nivelet e kualifikimit të audituesve të brendshëm që punonjë në këto struktura si dhe kompetencave të Njesisë QH/AB, lidhur me procesin e kualifikimit, certifikimit dhe trajnimit të vijueshëm të detyrueshëm, si strukture përgjegjëse për administrimin e këtyre proceseve,

Kemi rekomanduar:

- Ministria e Financave të ndërmarrë nismën ligjore për përmirësimin e ligjit “Për Auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”, duke patur në fokus edhe kriteret për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik, autoritetin që do të përcaktojë nivelin e këtyre strukturave dhe monitorimin e tyre. Sanksionimi i këtyre kriterëve në ligj do të mundësojë përgjegjshmëri më të lartë në plotësimin e kriterëve dhe do të rrisë përgjegjësinë për shkelësit e ligjit.

- Nga Ministria e Financave t'u kërkohet njësive të qeverisjes së përgjithshme ndërprerja e menjëhershme e marrëdhënieve të punësimit për të gjithë punonjësit (drejtorë njësie auditimi dhe auditues), të cilët rezultojnë të paçertifikuar, apo që arsimimi i tyre nuk përputhet me veprimtarinë e institucionit që auditojnë.

4. Me synim implementimin e një sistemi modern të menaxhit financiar dhe kontrollit, KLSH ka mbikëqyrur dhe vlerësuar kryesisht kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin financiar në administratën e institucioneve më të larta shtetërore, në ministri dhe institucione të pavarura, në organet e pushtetit vendor dhe në organet doganore. Mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi, komunikimi dhe monitorimi janë vlerësuar nga KLSH dhe në opinion të përgjithshëm, **Administrata jonë publike, me gjithë përpjekjet, është ende larg standardeve dhe praktikave më të mira të fushës, në drejtim të menaxhimit financiar dhe kontrollit.**

Kemi rekomanduar:

- Me ndarjen e re administrative, e cila do të mundësojë eliminimin e një sërë komunave, Ministria e Financave në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike duhet të marrin masa në lidhje me zbatimin e kërkesave Ligjit Nr.10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” në drejtim të përmbushjes së kriterit të arsimimit dhe të linjës së raportimit.

- Nga Ministria e Financave të mos aprovohet në asnjë rast konfirmimi i kryerjes së veprimeve në thesar për Nëpunësat Zbatues të Njesise Qendrore te Prokurimit, të cilët rezultojnë në kundërshtim me kriteret e kuadrit rregullator.

Nga auditimi për zbatimin e buxhetit vjetor 2013, në disa nga institucionet më të rëndësishme kemi konstatuar.

Vlerësimi i të ardhurave nga organet tatimore dhe doganore

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat, referuar treguesve të planifikuar dhe të rezultuar në fund të vitit janë realizuar 102.2 %, me një realizim prej 4.9 miliardë lekë më shumë kundrejt planit të korrigjuar, ndërsa kundrejt planit fillestar rezultojnë me një mosrealizim prej 26.1 miliardë lekë. Ky tregues kundrejt PBB-së gjatë këtij viti shënoi nivelin prej 16.9 %. Në grupin e të ardhurave **nga tatimet dhe doganat** peshën më të madhe e kanë **të ardhurat nga TVSH** të cilat përfaqësojnë 48.8 % të totalit të këtij grupi dhe që në raport me PBB-në rezultojnë me një nivel prej 8.2 %. Ato paraqiten me një realizim 102.6 % dhe me një tejkalim prej 2.8 miliardë lekë.

Mbi administrimin e të ardhurave buxhetore nga organet tatimore

Për vitin 2013 konstatohet një realizim i planit të të ardhurave të administratës tatimore në nivelin 105.7 %. Ndërsa kundrejt të ardhurave faktike të vitit 2012 konstatohet një rënie në totalin e të ardhurave me 9 miliardë lekë. Për vitin 2013 konstatohet se buxhetit fillestar është korrigjuar dy herë gjatë vitit dhe me aktin normativ të Tetorit 2013, plani i të ardhurave u ul me 14.8 miliardë lekë ndërsa rishikimi në fund të vitit i të ardhurave nga tatimet rezultoi me një rritje të planit prej 2.1 miliardë lekë. Realizimi faktik i të ardhurave kundrejt planit fillestar rezultoi me rreth 8 miliardë lekë më pak.

Mbi realizimin e të ardhurave tatimore sipas strukture

Kontribut më të madh në realizimin e planit në të ardhurat e mbledhura nga administrata tatimore kanë treguesit e tatimeve me 105 % dhe me mosrealizim në treguesit e sigurimeve me 99.5%. Në këtë realizim të treguesve të tatimeve ndikim më të madh kanë patur treguesit e taksave nacionale. Nëse analizojmë strukturën e të ardhurave tatimore për vitin 2013 kemi përsëri një peshë të lartë të tatimit mbi të ardhurat personale, ndërkohë që TVSH, vazhdon të mbetet me peshën më të lartë në të ardhura.

Borxhi Tatimor

Borxhi tatimor është rritur nga 69.9 miliardë në fillim të vitit 2013 në 79.2 miliardë në fund të vitit 2013. Përveç faktit se ka një rritje të nivelit të borxhit ka dhe një rritje të ritmit të rritjes së tij. Në vitin 2012 borxhi është rritur me 5,201 milion lekë, në krahasim me rritjen e borxhit për vitin 2013 prej 9,298 milion lekë. Gjithashtu vihet re një rënie e numrit të subjekteve me borxh gjë që nënkupton një rritje të mesatares së borxhit për secilin tatimpagues.

*Në zbatim të Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 4100, 149.b) të INTOSAI, mbështetur në rezultatet e auditimit për arsye të kufizimit në shkallë të gjerë të qëllimit dhe evidencave të auditimit, si dhe në mungesë të dhënjes së informacionit, **Kontrolli i Lartë i Shtetit e kishte të pamundur të jepte një opinion të kualifikuar mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për vitin 2013, me kërkesat dhe kriteret e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kryesisht, si dhe legjislacionit tjetër në fuqi.***

Me qëllim që të mos bllokojmë miratimin e buxhetit faktik 2013, KLSH në përmbushje të detyrimeve kushtetuese, e paraqet raportin për zbatimin e buxhetit faktik të vitit 2013, duke theksuar mosdhënien e opinionit të kualifikuar në lidhje me Administratën Tatimore për vitin 2013, por duke njohur dhe vlerësuar rezultatet e Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Financave në DPT të ushtruar në Tetor-Nëntor të vitit 2013, bazuar në standardin ISSAI 1610 “Auditimi i jashtëm përdor punën e auditimit të brendshëm” dhe në Marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Financave, nënshkruar më 08.05.2012.

KLSH, me synim vazhdimin e procesit të miratimit të buxhetit faktik nga Kuvendi, shpreh bindjen se vitin e ardhshëm nga ana e Ministrisë së Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, do të mundësohet lejimi i KLSH-së të kryejë auditim të plotë dhe pa kufizim konform Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit, duke mundësuar në këtë mënyrë një mbikqyrje efektive parlamentare në menaxhimin e financave publike. Theksojmë se qëllimi ynë nuk është të auditojmë subjektet private pra të kontrollojmë vetëvlerësimin tatimor të tyre por të auditojmë punën e administratës tatimore për vetëvlerësimin tatimor, gjithmonë duke mos kryer vizita fiskale në subjektet private.

Mbi administrimin e të ardhurave buxhetore nga organet doganore

KLSH për vitin 2013 në bazë të programeve të miratuara të auditimit ka ushtruar auditime ligjshmërie/rregullshmërie, në 10 degë doganore, si dhe një auditim ligjshmërie-rregullshmërie në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. KLSH ka gjetur mirëkuptimin dhe gadishmërinë e plotë të Drejtuesve të DP të Doganave për vënien në dispozicion të të dhënave dhe aksesit të nevojshëm në sistem duke kontribuar në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit jo vetëm të auditimeve por dhe të cilësisë së rekomandimeve duke vlerësuar maksimalisht dobishmërinë e sistemit doganor në vend, nga përmirësimet e vazhdueshme.

Realizimi i planit të të ardhurave doganore në vitin 2013, paraqitet me tre nivele:

- në krahasim me planin fillestar ai është realizuar në masën 89.4 %, me një diferencë (-) në vlerën 16,481 milionë lekë,
- në krahasim me planin e korrigjuar në muajin tetor, është realizuar në masën 102,7 %, me një diferencë (+) në vlerë 3,751 milionë lekë,
- në krahasim me planin e korrigjuar në dhjetor 2013 është realizuar në masën 101.5 % ose 2,053 milionë lekë më shumë,
- ndërsa në krahasim me faktin e vitit 2012 ai është realizuar në masën 107.5 %.

Mbi realizimin e të ardhurave doganore sipas strukturës

Duke patur parasysh ndryshimet vjetore të planit sipas strukturës rezulton se të ardhurat nga taksat doganore janë realizuar në masën 103.8 %, me një tejkalim prej 6,118 milionë lekë, të ardhurat nga akciza janë realizuar në masën 101.2 %, me një tejkalim prej 24,553 milionë lekë dhe të ardhurat nga TVSH-ja në doganë janë realizuar në masën 102.1 %, me një tejkalim prej 91,772 milionë lekë.

Nga auditimi rezulton se të ardhurat dytësore të realizuara në vitin 2013 janë në vlerë 412,662 mijë lekë dhe janë derdhur në buxhetin e shtetit në masën 100 % të tyre.

Detyrimet doganore (borxhi doganor)

Gjatë vitit 2013, borxhi doganor është shtuar me 1813 subjekte në vlerë 5,657 milionë lekë, është pakësuar me 1219 subjekte në vlerë 881 milionë lekë dhe në total paraqitet me 504 subjekte më shumë dhe në vlerë 4,776 milionë lekë më tepër, krahasuar me fundin e vitit 2012. Raporti i borxhit të shtuar me atë të pakësuar është rreth 6 herë më i lartë (5,657 milionë lekë/881 milionë lekë), i cili tregon se edhe për periudhën analizuese 2013 nga administrata doganore, veçanërisht nga strukturat e specializuara të saj, nuk është punuar me përgjegjshmëri në drejtim të zbatimit të legjislacionit për rikuperimin e borxhit doganor dhe minimizimin e krijimit të borxhit të ri.

Vlera e debitorëve në fund të vitit 2013 krahasuar me fillimin e vitit është në masën 216 % dhe numri i subjekteve debitoare në masën 150 %. Në zbatim të Ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011 “Për Legalizimin e Kapitalit dhe Faljen e një pjese të Borxhit Tatimor dhe Doganor” me ndryshime, rezulton që sipas nenit 26 të jenë falur shuma 12,970 milionë lekë për 3752 raste.

Nga auditimi i dhjetë degëve doganore për vitin 2013, **rezultuan shkelje të legjislacionit doganor** me pasojë mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në shumën prej 818.9 milionë lekë të cilat përbëhen nga: detyrime doganore të pallogaritura dhe të papaguara për mos zbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importimin e disa artikujve të ndryshëm, detyrime dhe penalitete të pavendosura për subjekte që operojnë me Regjim Përpunimi Aktiv, detyrime doganore të papaguara për diferencë në peshë me atë të deklaratës doganore, detyrime dhe penalitete të pavendosura për mospagim të TVSH, detyrime të pallogaritura dhe të papaguara për rentën minerare, detyrime doganore të papaguara në zhdoganimin e automjeteve, etj.

Mbi auditimin e zbatimit të buxhetit të pushtetit vendor

Gjatë vitit 2013, krahas auditimit të fondeve të pushtetit qëndror, jemi përqëndruar edhe në vlerësimin e punës të njërive të qeverisjes vendore, në mbledhjen e të ardhurave dhe përdorimin e fondeve në disipozicion të tyre. Për aktivitetin financiar, administrimin e pronës shtetërore dhe procesin e legalizimeve, kemi audituar njësi të pushtetit vendor, nga të cilat 10 bashki, 18 komuna, 2 këshilla qarqesh dhe 1 prefekturë.

Nga auditimi ka rezultuar se, të ardhurat në total në pushtetin vendor janë realizuar në masën 98.1%. Kundrejt të ardhurave të realizuara në vitin 2012, të ardhurat e realizuara në vitin 2013 janë ulur me 9.2 përqind.

Kemi konstatuar mangësi dhe rezerva në administrimin e të ardhurave. Ndër arsyt kryesore që kanë ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave në njësitë e qeverisjes vendore, përmendim:

1. Megjithëse janë hartuar udhëzime të përbashkëta ndërmjet Ministrisë së Financave me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në disa raste ato nuk kanë gjetur zbatim të plotë. Për pasojë, janë pakësuar ndjeshëm të ardhurat e njësive të qeverisjes vendore.
2. Mangësi në rakordimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Zyrave të Taksave në Bashki dhe Drejtorive Rajonale të të Tatim-Taksave në rreth, Zyrave të Gjendjes Civile, si dhe Zyrave të Regjistrimit të Pasurive, Zyrat e kadastrës, zyrës urbanistikës, duke reflektuar planifikim jo të saktë dhe në nivele të ulëta të taksave dhe tarifave vendore.

3. Edhe pse në vitin 2011, **u amnistuan detyrimet e papaguara, nga puna e pamjaftueshme e administratave tatimore të pushtetit vendor**, ende ka subjekte të parregullta, të cilët ushtrojnë aktivitet pa leje dhe nuk paguajnë detyrimet për taksat vendore. Ndërkohë nga zyrat e taksave vendore në bashki apo komuna, nuk kërkohet në të gjitha rastet ndëshkimi i tyre sipas legjislacionit në fuqi, si, vendosje gjobe, mbyllje e veprimtarisë, masë e konfiskimit, apo deri në kallzim penal në prokurori, për subjektet të cilën fshehin apo nuk paguajnë detyrimet tatimore.

4. Ende nuk ka një menaxhim dhe mirëadministrim të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, pasi në disa bashki edhe komuna nuk janë pasqyruar në kontabilitet detyrimet tatimore vendore, në kundërshtim me ligjin, duke mos ndjekur në vazhdimësi arkëtimin e debitorëve dhe lënë shteg për abuzime.

5. Edhe pse subjekteve të pushtetit vendor (biznesi i vogël) u është rimbursuar vlera e kasave fiskale, ato nuk përdoren, duke mos i shërbyer qëllimit të vendosur për pasqyrimin e xhiros dhe ritjen e pagesës së detyrimeve fiskale, ndërkohë ndaj subjekteve nuk zbatohen sanksionet e parashikuara në legjislacionin në fuqi.

6. Nga mungesa e strukturave dhe pamundësia praktike e mbledhjes nga popullata të taksës së ndërtesave, tarifës së pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, për çdo familje, rezulton se në mjaft prej tyre (në mbi 80% të bashkive dhe komunave), qytetarët nuk paguajnë taksat dhe tarifatat vendore.

Theksojme se dukuria e mospagesës së taksave të pastrimit dhe të ndërtesave nga popullata, konstatohet pothuajse në të gjitha bashkitë. Nga KLSH në përfundim të auditimeve me synim derdhjen në buxhet të të gjitha detyrimeve për këtë kategori taksash vendore, kemi rekomanduar **lidhjen e kontratave në cilësinë e agjentit tatimor me Ndërmarrjet e Ujësellsave Sh.a., apo me Operatorët e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.**

Në fushën e shpenzimeve, auditimet u përqëndruan në zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare të administrimit dhe përdorimit të fondeve buxhetore, në përfundim të të cilave, krahas punë së bërë, janë konstatuar dhe mjaft parregullsi dhe shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, si në fushën e pagave dhe shpërblimeve, në shpenzimet operative, në fushën e prokurimeve publike, zbatimit të punimeve etj. **Vlera e dëmit ekonomik të rezultuar si rrjedhojë e shkeljeve të dispozitave ligjore në fuqi, në 42 subjektet e audituara, llogaritet në shumën 685 milionë lekë ose 4.9 milionë euro.**

Në legalizimet e ndërtimeve informale, janë evidentuar parregullsi dhe shkelje ligjore që kanë sjellë si pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, të destinuara për fondin e kompensimit të ish-pronarëve në vlerën totale prej **1,15 miliardë lekë, ose rreth 8.2 milione euro**. Gjithashtu janë evidentuar dhe **512 raste**, ku legalizimi i ndërtimeve informale është bërë në zona të cilat nuk duhej të bëhej legalizimi, në kundërshtim me ligjin.

Mbi auditimin e kryer në Bankën e Shqipërisë

KLSH vlerëson politikat monetare të Bankës së Shqipërisë në ruajtjen e stabilitetit financiar, në kushtet e një krize të gjerë globale, me pasoja edhe për vendin tonë. Nga ana tjetër Kontrolli i Lartë i Shtetit e gjykon të rëndësishëm, ruajtjen e pacënuar të pavarësisë organizative dhe vepruese të Bankës Qëndrore në përmbushjen e misionit të saj kushtetues, duke vijuar me

konsolidimin e arritjeve në fushën e politikës monetare, krahas shikimit me një sy tejet kritik të mangësive në mbikëqyrje dhe administrimin e fondeve në dispozicion. Kemi nënvizuar gjithashtu se përmirësimet ligjore të synuara duhet të zhvillohen në konsultim të ngushtë me institucionet e rëndësishme financiare ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore si edhe Bankës Qendrore Europiane.

1. Nisur nga funksionet që Ligji nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i ka atribuar Këshillit Mbikëqyrës në politikbërje, mbikëqyrje dhe administrimin e këtij institucioni por dhe raporteve të përfaqësimit të administrimit në Këshill sipas përcaktimeve në këtë ligj, duke vlerësuar si të rrezikuar vendimmarrjen sidomos në rastet kur Inspektori i Përgjithshëm vlerëson negativisht performancën e Bankës, tërësore ose pjesore, atëherë ka mundësi në masë të konsiderueshme që të mos realizohet kourumi i nevojshëm brenda këtij Këshilli për përmirësime të situatës,

Kemi rekomanduar

- **Përfaqësimi i administrimit në Këshillin Mbikëqyrës të bëhet vetëm nga Guvernatori, për t'i dhënë hapësirën e nevojshme Këshillit Mbikëqyrës për të kryer saktësisht funksionet mbikëqyrëse që atij i atribohen me ligj dhe shmangur pozitën e sotme “dominuese” të administrimit në Këshillin Mbikëqyrës** (3 anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës janë ligjërisht në nivelin më të lartë të administrimit). Eksperienca e bankave qendrore të vendeve të zhvilluara ka dëshmuar se prania vetëm e Guvernatorit në nivele të tilla vendimmarrëse është mëse e mjaftueshme dhe ndarja e funksioneve të administrimit nga politikbërja dhe mbikëqyrja sjellin efekte pozitive në nivelin e transparencës dhe llogaridhënies.

- **Saktësimin e detyrave funksionale të Këshillit Mbikëqyrës dhe administratorëve të Bankës**, për të shmangur dualizmin e funksioneve, konfliktin e kompetencave dhe për të siguruar një nivel të dëshirueshëm llogaridhënie, transparence dhe mbikëqyrjeje.

Në përgjigjen për qëndrimin e saj ndaj Raportit Përfundimtar të Auditimit, Banka nuk shprehet për këtë rekomandim.

2. Nisur nga fakti se Këshilli i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë është një bord specifik me detyra të rëndësishme dhe komplekse të lidhura me drejtimin dhe monitorimin e një tregu të rëndësishëm si ai monetar, me reflektime të qarta dhe të mprehta në gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë, faktit që bazuar në rregullat e brendshme të Bankës, konfliktit të interesit për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund ti jepet një kuptim më i gjerë se në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”,

Kemi sygjeruar:

- **Vendosjen e kufizimit të plotë të pjesëmarrjes së tyre në këshilla dhe borde të tjerë përveç atyre të fushës akademike dhe shkencore.**

- **Të kërkohet mospërdorimi i figurës në aktivitete apo promovime që cenojnë integritetin e figurës së anëtarit të një bordi kaq të rëndësishëm.**

- **Kufizimi i daljeve publike dhe mbajtjes së qëndrimeve individuale mbi aspekte të politikës monetare në një kohë që paraqitet një qëndrim i Këshillit Mbikëqyrës në deklaratën për shtyp të Guvernatorit, pasi kjo mund të nxisë refleksione dhe reagime jokorrekte të operatorëve në treg.**

- Ndërkohë, duke vlerësuar maksimalisht kontributin e tyre në jetën publike dhe ekonomike të vendit, dhe vetë sfidat që ka përpara ky Institucion i rëndësisë së veçantë, për tu përballuar me realitete të mbartura nga e kaluara, i kërkojmë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të japin dorëheqje nga bordet dhe pjesëmarrjet e tjera publike dhe politike dhe aq më tepër përdorimit të figurës së tyre, në dobi të bizneseve private, përfshirë dhe ato të reklamimit të sistemit universitar privat në vend.

Në përgjigjen e saj, Banka thekson se këto rekomandime nuk pranohen. Sipas saj ky rekomandim mund të adresohet pranë Kuvendit të Shqipërisë si institucion ligjvënës i ngarkuar nga Kushtetuta për të realizuar veprimtarinë legjislative në Republikën e Shqipërisë, pasi në kuadrin ligjor ekzistues nuk ka asnjë kufizim ligjor për pjesëmarrje në borde të ndryshme profesionale apo të shoqërisë civile. I vetmi kufizim ligjor për anëtarët e Këshillit është pjesëmarrja në aktivitete politike, sipas nenit 47 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

3. Banka e Shqipërisë është përpjekur për një politikës monetare lehtësuese të ndjekur edhe gjatë vitit 2013, duke reduktuar normën bazë të intesetit me 1 pikë përqindje në krahasim me vitin 2012, nëpërmjet katër vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës. Kemi konstatuar se kjo politikë është shoqëruar me rënien e ndjeshme të normave të interesit për depozitat e kursimit dhe uljen e kostos së bankave. Nga ana tjetër, konstatimet mbi gjëndjen aktuale të tregut, trendin e kanalizimit të fondeve dhe ndikimi në kreditim, kanë treguar se **tregu financiar shqiptar ka patur një ndjeshmëri të ulët ndaj normave të interesit.** Duke dashur të jemi të kujdesshëm dhe të mos ndërhyjmë dhe cënojmë sado pak pavarësinë e saj në zbatimin e politikës monetare sugjerojmë që **Banka e Shqipërisë të vlerësojë me kujdes instrumentet që do të përdorë në të ardhmen për plotësimin me efektivitet të objektivave kryesorë të saj.**

Nga ana e Bankës, ky rekomandim quhet i papranueshëm, për faktin se e drejta dhe detyrimi i Bankës së Shqipërisë për zbatimin në mënyrë të pavaruar të politikës monetare është një e drejtë e njohur në Kushtetutë.

Theksojmë se Institucionet Supreme të Auditimit nuk mund të gjykojnë dhe auditojnë politikën, por vlerësimi i efektivitetit dhe rezultatet e politikave janë funksionet e tyre kryesore në ditët e sotme. Vlerësimi i performacës është misioni që kërkohet të përmbushet nga një institucion i auditimit të jashtëm i standardeve europiane dhe drejt të cilit ne po mundohemi të zhvendosemi me shpejtësi. Gjithsesi, duke vlerësuar maksimalisht kapacitetet profesionale të Bankës së Shqipërisë në këtë fushë, rekomandimet tona kanë qënë të kujdesshme dhe modeste.

4. Nga auditimi i rregullshmërisë së zhvillimit të ankandëve të bonove të thesarit dhe obligacioneve të organizuara nga Banka e Shqipërisë, në zbatim të marrëveshjeve të lidhura midis Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë, kemi konstatuar se Banka e Shqipërisë është pjesëmarrëse në ankandet që zhvillohen për bono thesari, *me të drejtën e rezervimit të shumës së kërkuar prej saj*, pavarësisht nëse kërkesat jokonkuruese nga ana e individëve mund të jenë të larta. Niveli i pjesëmarrjes së individëve nëpërmjet kërkesave jokonkuruese në ankandet e obligacioneve është mjaft i ulët, vetëm 1 % të shumës totale të emetuar gjatë vitit 2013.

Kemi rekomanduar:

Banka e Shqipërisë, në rolin e saj këshillimor për qeverinë, të ndikojë në marrjen në konsideratë të mekanizmave më të efektshëm, **më qëllim që jo vetëm të mos ulet, por të nxitet pjesëmarrja më e gjerë e individëve në tregun e instrumentave të emetuar nga qeveria, gjithashtu të ndikojë për rritjen e shkallës së informimit të publikut mbi këtë treg.**

Ky rekomandim nga ana e Bankës quhet i papranueshëm, pasi sipas saj marketingu për një letër borxhi bëhet vetëm nga emetuesi. Instrumentet e politikës monetare kanë si objektiv të drejtëpërdrejtë dhe të vetëm zbatimin e politikës monetare. Theksojmë si KLSH se rekomandimi nuk i kërkon Bankës të bëjë marketingun e letrave të qeverisë, por i kemi kërkuar të këshillojë qeverinë për një marketing më të mirë të instrumentave afatshkurtër, apo mekanizmave që do të sillnin që niveli i pjesëmarrjes së individëve në këto instrumenta të rritet.

5. Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” përcakton se Banka e Shqipërisë është e pavarur në përcaktimin e shpërblimeve të stafit të saj, pavarësi që sipas nenit 45 i njeh të drejtën Këshillit Mbikëqyrës që të vendosi për llojin, nivelin e pagave dhe shpërblimeve. Shpenzimet e personelit kanë patur një rritje të lehtë për vitin 2013 dhe kjo tregon një trend të konsoliduar rritës të këtij zëri që zë 35% të totalit të shpenzimeve të Bankës. Nga Banka mbrohet me fanatizëm fakti që pagat janë të larta për të mundësuar mbajtjen e stafit të kualifikuar por pamundësia për të patur akses në të dhënat mbi kapacitetet profesionale të këtij stafi (dosjet e personelit nuk na u vunë në dispozicion nga ana e bankës nën arsyetimin e konfidencialitetit) nuk na lejon të gjykojmë mbi këtë pretendim të ngritur nga Banka.

Kemi rekomanduar:

- Rishikimin e ligjit, në frymën e minimizimit të riskut potencial të abuzimit me pavarësinë dhe shmangies së konfliktit të interesit që evidentohet në praktikën e përcaktimit të pagave dhe shpërblimeve për nivelet drejtuese.

- Përcaktimi i një kornize të kujdesshme rregullatore në lidhje me nivelin e pagës së Guvernatorit, e cila duhet të ndjekë trendin e pagave të tregut bankar, por gjithmonë duhet të jetë në raporte të pranueshme, krahasuar me pagën e Presidentit të Republikës, bazuar kjo jo vetëm në përvojat dhe praktikën më të mira të vendeve të ngjashme, por edhe në përshtatshmërinë me realitetin shqiptar (rekomandim i mëparshëm).

- Kërkesën për një transparencë të detyrueshme ligjore për çdo vendim të lidhur me pagat dhe shpërblimet e stafit dhe jo vetëm, çka presupozon informimin e vazhdueshëm të opinionit të gjerë publik në lidhje me çdo përfitim financiar dhe monetar.

Banka, në përgjigjen e saj nuk pranon rekomandimin, pasi sipas tyre rekomandimi del jashtë objektit të veprimtarisë së KLSH, por gjykohet edhe i pabazuar, pasi në bazë të dispozitave në fuqi këto janë kompetenca të Këshillit Mbikëqyrës. Çdo ndryshim i tyre realizohet nga Kuvendi i Shqipërisë.

6. Auditimi konstatoi se pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me politikat kontabël të përshtatura në Manualin e Kontabilitetit të Bankës, miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr. 50, datë 26 janar 2001 por dhe politika të tjera të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës duke tentuar një pajtueshmëri të përgjithshme me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të aprovuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Pavarësisht këtij përafrimi të synuar, theksojmë se baza e pasqyrave janë ato të Manualit të Kontabilitetit të vetë Bankës. Bazuar në këtë konstatim por

edhe në funksion të rritjes së cilësisë së informacionit të publikueshëm nga ana e Bankës për të gjithë përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm

Kemi rekomanduar:

- Banka të kalojë në përgatitjen e pasqyrave në përputhje të plotë me standardet e raportimit financiar (SNRF), të bëjë rishikimin e Manualit të Kontabilitetit të Bankës në të cilin të jenë të shpjeguara gjerësisht deviacionet që mund të ketë implementimi i plotë i SNRF në kushtet reale të vendit dhe duke zvogëluar ndërhyrjet e Këshillit Mbikëqyrës në këtë drejtim.
- Në funksion të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, të jepet një nivel i tillë shënimesh shpjeguese që lejon lexuesin të krijojë bindje objektive për politikën kontabël të përdorur për zëra të veçantë dhe impaktin e kësaj politike kontabël në pasqyrat e paraqitura nga Banka.
- Banka të stimulojë me një politikë të kujdesshme ngritjen e kapaciteteve njerëzore të përfshira në këtë proces sa kompleks dhe të rëndësishëm për rritjen e besueshmërisë së informacionit për pozicionin financiar të bankës.

Banka në përgjigjen e saj shpreh dakordësinë për këtë rekomandim dhe thekson se po merren masa për zbatimin e tij.

7. Nga auditimi i funksionit të Departamentit të Kontrollit, nisur nga raporti vjetor i aktivitetit të këtij funksioni për vitin 2013, intervistimi i inspektorit të përgjithshëm si dhe pyetësi i plotësuar mbi aktivitetin e auditit të brendshëm në Bankën e Shqipërisë arritëm në konkluzionin se **pavarësia e funksionimit të auditimit të brendshëm të Bankës së Shqipërisë, nuk mund të inkurajohet nga ana e administratorëve nëse ata përcaktojnë strukturën dhe buxhetin e këtij funksioni.** Gjithashtu e kemi konsideruar si çenim të pavarësisë, mënyrën e planifikimit të misionëve të auditimit por dhe moszbatueshmërinë e rekomandimeve të lëna nga këto misione audituese.

- Bazuar në gjetjet e këtij auditimi, në funksion të rritjes së pavarësisë, efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së strukturës së auditimit kemi rekomanduar **që të bëhen përmirësime ligjore duke transformuar funksionin e Inspektorit të Përgjithshëm në një Komitet Auditimi** të përbërë nga tre anëtarë, të zgjedhur nga Kuvendi.

- Ndërkohë, Bankës i kemi kërkuar të rishikohet baza e brendshme rregullative lidhur me këtë funksion kryesisht lidhur me **forcimin e pavarësisë së kësaj njësie në planifikim dhe në mënyrën e raportimit.** Të shikohet mundësia e ndryshimit të mënyrës së rekrutimit dhe shpërblimit të stafit në përbërje të Drejtorisë së Kontrollit të Bankës së Shqipërisë, të punohet për ngritje të mëtejshme të kapaciteteve brenda tij. Kemi cilësuar nevojën për përmirësim në drejtim të monitorimit të kuadrit të centralizuar të riskut si edhe në aspektet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë së punës së audituesve dhe funksionit në përgjithësi. **Vendosja e mekanizmave që do të përshpejtojnë zbatimin e rekomandimeve të lëna nga departamenti i kontrollit.**

Buxheti i Sigurimeve Shoqërore

Kemi konstatuar sërish se skema aktuale e sigurimeve shoqërore shfaq problematika si në procesin e realizimit të të ardhurave dhe në realizimin e shpenzimeve, të shoqëruara me rritje nga viti në vit të subvencionimeve buxhetore.

Konstatohet një nivel kontributiv më i ulët, fakt që ka sjellë që plani vjetor fillestar i të ardhurave prej 48,918 milion lekë të realizohet vetëm 98.73 % duke krijuar një defiçit në të ardhura me 622 milion lekë.

Ndër faktorët kryesor të këtij mosrealizimi janë mosrealizimi i numrit të kontribuesve, numri i ulët i kontribuesve për një subjekt si dhe rritje e numrit të punonjësve me pagë minimale. Mjafton të përmendim një fakt të thjeshtë nga konstatimet tona, subjektet e pajisura me leje për shfrytëzim mineral rezultojnë të kenë prodhuar sasi të konsiderueshme në mijëra tonë mineral, por numri i punëtorëve në këto subjekte varion nga 2-4 punonjës.

Gjithashtu, konstatohet rritje e detyrimeve të papaguara ndaj skemës së sigurimeve vetëm për vitin 2013, me rreth 1,9 miliardë lekë, kjo ka sjellë që stoku i detyrimeve kontributive të papaguara nga subjektet juridik dhe fizikë në fund të vitit 2013 të arrijë në 10 miliardë lekë, detyrimeve që përfaqësojnë, kontribute, interesat dhe gjokat e papaguara, të pa mbledhura nga organet tatimore.

Plani i të ardhurave të planifikuara për t'u mbledhur nga vetë ISSH është *realizuar 100.1%*, pavarësisht tendencës në rënie të numrit fizik të kontribuesve si të vetëpunësuar në bujqësi. Skemës së sigurimeve shoqërore në fshat i mungon një numër relativisht i lartë i personash, që vlerësohet të jetë 113,377 kontribues.

Nga auditimi i shpenzimeve për buxhetin e Sigurimeve Shoqërore, rezultoi se programi përfundimtar i shpenzimeve, i miratuar me ligjin për buxhetin e vitit 2013, nga 95,395 milionë lekë të programuara, është realizuar në shumën 95,596.6 milionë lekë, pra konstatohet një tejkalim prej + 201.6 milionë lekësh.

Konstatohet se defiçiti i degës së pensioneve po thellohet nga viti në vit dhe, bazuar në treguesit e buxhetit afatmesëm, parashikohet të thellohet edhe në tre vitet e ardhshme, duke bërë të domosdoshme marrjen e masave konkrete dhe reformimin e thellë të Sistemit të Sigurimeve Shoqërore.

Kemi rekomanduar një sere masash perpermiresimin e gjendjes, por theksojmë se është e rëndësishme dhe domosdoshme miratimi i ndryshimeve ligjore për skemën e sigurimeve shoqërore (nismë tashmë realizuar pjesërisht), si dhe marrja e masave shtrënguese në detyrimin e subjekteve publike dhe private, për derdhjen e detyrimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, te cilat së bashku do të përmirësojnë situatën për defiçitin e krijuar.

Rekomandimet e KLSH, të lëna si në drejtim të përmirësimeve ligjore të akteve në fuqi, ashtu dhe për hartimin e marrëveshjeve ndërinstitucionale dhe masat organizative brenda ISSH, nëse zbatohen, mund të përmirësojnë skemën e Sigurimeve Shoqërore dhe ndalojnë “hemorragjinë” e defiçitit të pensioneve.

Buxheti i Sigurimeve Shëndetësore

Nga auditimi i ushtruar në Fondin e Kujdesit Shëndetësor, konstatuam të ardhurat gjithsej, janë realizuar në masën 7,3 miliardë lekë nga kontributet ndërsa pjesa tjetër janë transfera të buxhetit të shtetit 23,2 miliardë lekë. Përsa u përket të ardhurave nga kontributet shëndetësore të fermerëve, janë realizuar në masën 66%.

Shpenzimet faktike gjatë vitit 2013 në krahasim me faktin e vitit 2012 janë rritur në vlerën 864 milionë lekë, ose niveli i realizimit është 105.6 %, pasi nga 15,446 milionë lekë të shpenzuara gjatë vitit 2012, evidentohet se në vitin 2013 janë shpenzuar 16,310 milionë lekë.

Kemi konstatuar se ka patur mangësi në mënyrën e planifikimit të shërbimit shëndetësor, referuar mënyrës së llogaritjes dhe vlerësimit të kostos së shërbimeve spitalore, problem i cili nuk ka gjetur zgjidhje *duke sjellë si pasojë që buxheti i vitit 2014, por edhe projektbuxheti i vitit 2015 për shërbimin spitalor të hartohet bazuar vetëm në të dhëna historike. Kemi rekomanduar të intensifikohet puna e nisur gjatë vitit 2014 nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshën të Kujdesit Shëndetësor, në lidhje me hartimin dhe miratimin e kostos së shërbimeve kryesore spitalore me efekte financiare për buxhetin e kujdesit shëndetësor.*

Të sigurohet që pacientët të marrin paketa të përcaktuara dhe të kontraktuara midis blerësit të shërbimit dhe qendrës shëndetësore, apo ofruesit tjetër të shërbimit që mund të jetë spitali publik, ose spitali privat. Trasparencën e konsiderojmë të rëndësishme në këtë proces.

Kemi rekomanduar po ashtu, **që të përcaktohet një mënyrë më efektive për të saktësuar ngarkesën e mjekut të familjes**, kjo pasi rezulton se ngarkesa faktike banorë/për mjek familje është duke arritur kufijtë maksimalë, krahasuar me normën dhe maksimumin e normës, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë. Kemi kërkuar pastrimin në vazhdimësi të regjistrit elektronik të banorëve nga dublimet dhe bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për përcaktimin e saktë të banorëve, kjo pasi kemi konstatuar se institucioni administron një regjister elektronik të banorëve, me mbi 4 milion banorë në total në rang vendi.

Për të siguruar zbulimin dhe dënimin e fenomeneve abuzuese me skemën e sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor, duke u përqëndruar të veprimtaria e mjekut të familjes, mjekut specialist, farmacistët dhe të siguruarit nga skema, kemi rekomanduar të ushtrohet kontroll më i hollësishëm në QSUT dhe KMCAP, në lidhje me rekomandimet e dhënies së barnave për trajtimin e të siguruarve, të harmonizohen kontrollet e plota me kontrollet tematike për rajonet që kanë tejkalim të planit të rimbursimit gjatë vitit.

Bazuar në evidencat e FSDKSH-së, konstatohet se për vitin 2013, vazhdon të mbetet i palikuiduar detyrimi i prapambetur i vitit 2012, i ISSH ndaj FSDKSH në shumën 215.4 milionë lekë, ku për arkëtimin e kësaj vlere duhet të negociohet midis Ministrisë së Financave dhe ISSH (Që nga prilli i vitit 2013 nuk ka më marrëdhënie midis ISSH e FSDKSH për shumën e transfertës së kontributeve nga TSA).

Mbi auditimin e kryer për manaxhimin e burimeve natyrore

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi **Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore** (e cila auditohet për herë të parë që nga krijimi në vitin 2006) në drejtim të transaksioneve financiare dhe në zbatimin e procedurave ligjore si dhe përmbushjen e detyrave funksionale të kësaj Agjencie për periudhën e aktivitetit të vitit 2013, ku duhet theksuar fakti që audituesit e KLSH patën qasje të

kufizuar në dokumentacionin e marrëveshjeve hidrokarbure, duke e shtyrë auditimin e plotë të këtij sektori për periudhën në vijim.

Nga auditimi i AKBN, rezultoi si vijon:

1. Kjo Agjenci në veprimtarinë e saj administrativo –ligjore është vetëpërgjashtuar nga rregullat për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore duke funksionuar me një status “hibrid”, pa përcaktime të sakta ligjore të cilat të rregullojnë veprimtarinë e saj. Kjo ka sjellë dhe shpenzime të pajustificuara apo dëm në mënyrën e administrimit të fondeve në dispozicion, ku vetëm për vitin 2013 ky keqpërdorim arrin në vlerën prej **34,5 milionë lekë**.

2. Në funksionimin e AKBN është konstatuar mungesë rakordimi të veprimeve me Autoritetin Kontraktor (Ministria e Energjitikes dhe Industrise-MEI) për monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të kontratave. Veçanërisht mbi dokumentacionin ekonomiko-financiar që duhet të paraqesin koncesionarët për zbatimin e kontratës në faza të ndryshme të ndërtimit (balance, fatura, etj), të cilat në shumë raste mungojnë, ose nuk janë të firmosura sipas bazës ligjore, mungesa e dokumentacionit ka bërë të pamundur vlerësimin real të investimeve të kryera, duke sjellë edhe pamundësinë e llogaritjes së penalteteve nga Autoriteti Kontraktor. Një shkak për gjendjen e krijuar në fushën e dokumentacionit për monitorimin është nënshkrimi i kontratave ndërmjet ish METE dhe koncesionarëve, pa përfshirë AKBN, si institucioni monitorues,.

3. Nga auditimi konstatohet se, për HEC-et që kanë filluar prodhimin e energjisë elektrike, nuk ndiqen detyrimet e koncesionarit për kryerjen e testimit të vepres energjetike, vlerësimin e investimit, detyrimet e koncesionarit për derdhjen në vlerë në arkën e MEI të tarifës koncesionare sipas kontratës, dhe rakordimet vjetore, për të përcaktuar përmbushjen e detyrimit për prodhimin e energjisë elektrike vjetore sipas kontratës.

4. Nga auditimi i dokumentacionit (që nuk është i plotë), ka rezultuar se KESH sh.a., që në bazë të një kontrate me koncesionarin, merr në dorëzim për llogari të MEI sasinë e energjisë elektrike të prodhuar, me fatura mujore, ka mbajtur tarifen koncesionare sipas energjisë elektrike të prodhuar dhe sipas tarifës në përqindje. **KESH sh.a. detyrohet që vlerën e tarifës koncesionare, ta derdhë në arkën e Ministrisë të Energjisë dhe Industrisë, por që me argumentin e vështirësive financiare, nuk e ka derdhur.** Përveç tarifes koncesionare, koncesionari për mosrealizimin e prodhimit vjetor të energjisë elektrike për faj të tij, penalizohet me 5 % të vlerës të energjisë elektrike të parealizuar, duke llogaritur të plotë edhe tarifen koncesionare, dhe jo sipas prodhimit faktik të realizuar. Këto llogaritje nuk janë bërë nga Autoriteti Kontraktor.

5. Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se për vitin 2013, nuk është kryer testimi i HEC-eve që janë vënë në punë, duke mos zbatuar procedurat e përcaktuara në Kontratës Koncesionare. Moskryerja e këtyre procedurave në prani të përfaqësuesve të Autoritetit Kontraktor dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, nuk ka dhënë mundësi të përcaktohet nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara për fuqinë e vendosur, makineritë e vëna në HEC, llojet, origjina e tyre etj.

Në lidhje me auditimin për **monitorimin e lejeve e liçensave të shfrytëzimit të burimeve natyrore minerare** rezultoi se:

1. Agjensia kombetare e burimeve natyrore (AKBN) nuk ka hartuar asnjë raport monitorimi për të dy gjashtëmujorët e vitit 2012 bazuar mbi mbikqyrjen që duhet të kryenin gjatë kësaj periudhe në subjektet që ushtrojnë veprimtari të shfrytëzimit minerar, duke mospërbushur detyrimin ligjor të saj megjithëse **ka kryer shpenzime dhe përdorur fonde për hartimin e raporteve të monitorimit.**

2. Në raportin e vitit 2013, shumë nga treguesit e monitorimit të lejeve minerare nuk janë koherentë duke humbur besueshmërinë e gjendjes reale të treguesve të aktivitetit të lejeve minerare, pasi bazohen në raportet dhe akt konstatimet e viteve të mëparshme apo vetëdeklarimet e vetë subjekteve. Mënyra e trajtimit nga ana e specialistëve dhe masat e propozuara nga drejtuesit e AKBN gjatë vitit 2013 nuk kanë qenë në mbrojtje të interesave të shtetit. Mos aplikimi i masave administrativo-ligjore nga ky institucion, ka lejuar abuzimin nga ana e shoqërive koncesionare, të cilat gëzojnë leje shfrytëzimi të bëjnë një shfrytëzim gati barbar të burimeve nëntokësore, duke shkatërruar në shumicën e rasteve zonat mjedisore në të cilat ata operojnë.

3. Nga auditimi u konstatua se në shumë rrethe të vendit zhvillohet **aktivitet minerar** nga ana e subjekteve të palicencuara, të cilat jo vetëm zhvillojnë veprimtari të paligjshme, por sjellin edhe një dëm mjedisor si nga pikëpamja vizive, por edhe nga emetimet në atmosferën përreth të gazrave të dëmshëm. Nga strukturat përgjegjëse nuk janë merren masa që në bashkëpunim me pushtetin lokal të kërkohet dhe ndihma e Policisë së Shtetit, duke bërë evidentimin dhe ndalimin e subjekteve të palicensuar, që zhvillojnë aktivitet privat minerar të paligjshëm. Në zona të ndryshme konstatohen **raste të tjetërsimit të lejes minerare të shfrytëzimit** të persona të tjerë në mënyrë të paligjshme dhe deri në ushtrimin e aktivitetit prodhues minerar në zona të palicensuara.

5. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga sektori i Garancive dhe Rehabilitimit Mjedisor rezulton se nga **741** subjekte të rregjistruara me leje minerare rreth **393** subjekte nuk kanë depozituar asnjë vlerë monetare, si **garanci për rehabilitimin e zonës**, në shkelje të ligjit minerar. **AKBN ka lejuar që keto subjekte të mos e zbatojnë këtë detyrim ligjor, mungesa e kësaj garancie rrezikon dhe shuan mundësinë e rikthimit të këtyre zonave në gjendjen mjedisore të mëparshme, duke i shkatërruar përfundimisht ato.** Rreth 121 subjekteve për të cilat është propozuar **revokimi i lejes minerare**, rezulton të kenë garanci financiare të padepozituara për vitin 2011 dhe vitin 2012 në vlerë të përlogartur në shumën **88.6 milionë lekë**, të cilat duhet të kalonin në favor të buxhetit të shtetit dhe **të përdorreshin për rehabilitimin e zonave ku është kryer veprimtaria minerare.**

Pavarsisht se gjendja paraqitet tejet e rëndë dhe jashtë çdo autoriteti të shtetit mbi pasuritë kombëtare të cilat vazhdojnë të përdoren në mënyrë të jashtëligjshme, shkatërrohet mjedisi në mënyrën më barbare dhe shfrytëzohen njerëz si në mesjete, autoritet shtetërore përgjegjëse për të marrë masa dhe ndëshkuar cilindo që dhunon e cënon pasurinë kombëtare mjaftohen me raporte të vazhdueshme të cilat në shumicën e rasteve mbeten në sirtarët apo arkivat e

institucioneve si dëshmi e shkatërrimit, përballë apatisë së instancave shtetërore, kryesisht për mungesë vullneti dhe bashkëpunimi.

KLSH vlereson nismen për ndryshime ligjore në ligjin Minerar, ndryshime të miratuara nga Kuvendi me datë 8 tetor 2014, të cilat ndihmojnë në përmirësimin e situatës së rëndë në aktivitetin minierar të vendit.

Mbi auditimin e saktësisë së detyrimeve të prapambetura të deklaruara si borxh deri në datën 31.12.2013 në ARSH dhe QSUT.

Në respekt të kërkesës së Fondit Monetar Ndërkombëtar, është ndërmarrë një auditim tematik lidhur me saktësinë e detyrimeve të prapambetura të deklaruara si borxh deri në datën 31.12.2013, bazuar në materialin e përgatitur nga eksperti ndërkombëtar i kontraktuar nga qeveria. Ky mision u realizua në respekt të kërkesës së misionit të FMN dhe në kushtet kur nuk u arrit të nënshkruhej memorandum i bashkëpunimit me Ministrinë e Financave, pavarësisht mirëkuptimit dhe dakordësisë së MoF me KLSH, për shkak të problematikës së auditimit të detyrimeve për TVSH. Auditimi u realizua mbi listën e detyrimeve për investimet në infrastrukturën rrugore deklaruar nga ARrSH dhe në detyrimet e mallrave dhe shërbimeve të QSUT.

Mbi auditimin e borxhit në ARrSH

Nga auditimi i kësaj liste në Autoritetin Rrugor Shqiptar rezultoi se raportimi zyrtar i detyrimeve të prapambetura, të njohura, por të papaguara nga ARrSH datë 31.12.2013, me vlerë 14,419 milionë lekë, **nuk është i saktë dhe duhet të saktësohet duke zbritur vlerën 880 milionë lekë.**

Nr.	EMËRTIMI	Vlera e papaguar dhe paraqitur si borxh deri 31.12.2013	Vlera e papaguar dhe paraqitur si borxh pas konstatimeve KLSH	Devijimi (në ulje) 000/lekë
1	Zhvillimi i projekteve të brendshme projekteve	11,415,349	11,054,949	360,400
2	Studime projekte (brendshme huaja)	451,666	408,101	43,565
3	Shpronësime	1,105,971	752,360	353,611
4	Vendime gjyqësore	426,217	426,217	-
5	Kosto lokale dhe TVSH	1,020,635	897,980	122,655
6	Shuma	14,419,838	13,539,607	880,231

1/a. Zhvillimi i projekteve të brendshme, është paraqitur me **360 milionë lekë më tepër**, për shkak të rritjes së padrejtë të vlerës së detyrimit të prapambetur në projektet ose veprimeve të pasakta financiare të konstatuara nga auditimi i KLSH.

1/b. Shpronësimet, janë paraqitur me **353,6 milionë lekë më tepër**, si rezultat i gabimeve në klasifikimin e bërë nga personat përgjegjës.

1/c. Studim projektim, është paraqitur më tepër **43,6 milionë lekë**, si rezultat i mos rakordimit në vazhdimësi të likuidimeve midis Sektorit të Projekteve dhe Sektorit të Financës.

1/d. TVSH dhe kosto lokale paraqitur më tepër **122,7 milionë lekë** si rezultat i interpretimit të gabuar për garanci punimesh.

I kemi kërkuar ARrSH, të njoftojë Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, si dhe Ministrinë e Financave, për ndryshimin në zbritje të vlerës reale të detyrimit e prapambetura datë 31.12.2013, me 880 milion lekë, me qëllim reflektimin e tij për detyrimet në vijim.

Gjithashtu kemi lënë rekomandime të cilat i shërbejnë mirëadministrimit të këtyre kontratave në të ardhmen në mënyrë që sigurohet saktësia e të dhënave dhe detyrime të ndjekura me përgjegjshmëri më të madhe.

Mbi auditimin e borxhit në QSUT

Nga auditimi në QSUT ka rezultuar se sipas bilancit të datës 31.12.2013 vlera totale e detyrimeve të krijuara gjatë viteve për barnat farmaceutike është 2 miliardë lekë, ndërsa për ato jo farmaceutike, investime, shpenzime për ujë, shpenzime për vendime gjyqi, blerje gazi dhe karburanti etj. janë 1,5 miliardë lekë. Pra detyrimi i prapambetur për tu likuiduar është në vlerën totale prej **3,56 miliardë lekë**. Auditimi konsatoi parregullsi në rastin e detyrimeve të paguara për konsum të medikamentit “Cerezyne”. Kjo parregullsi i referohet mos dokumentimit të sasisë së medikamentit të përfituar si donacion dhe atij që duhej të përballohej nga fonde buxhetore. Konstatuam që në total me praktika të gabuara, dhe të padokumentuara plotësisht, janë njohur si detyrim buxhetor dhe likuiduar **111 milionë lekë**. Kemi rekomanduar që të investigohet nga auditi i brendshëm i MSH, praktika e plotë (duke filluar nga viti 2012 deri qershor 2014), për barnat e përfituara me donacion, lidhur me evidentimin e saktë të pacientëve të trajtuar dhe sasisë së konsumuar nga ata sipas protokolleve mjeksore. Nisur nga ky konstatim kemi kërkuar të njëjtën procedurë auditimi për të gjitha barnat që QSUT, ka përfituar me donacione të ndryshme. Kërkohet të hartohet një rregullore e plotë e evidentimit, kontabilizimit dhe përdorimit të tyre në këtë institucion.

Në praktikën e likuidimeve të barnave, u konstatua marrja e mallrave me metodën e “borxhit”, madje kryerjet e këtij veprimi ishin në metodën e punës (praktikë që vepron akoma), veprime që kishin miratimin e titullarit të institucionit duke caktuar edhe një komision të veçantë për marrjen e mallrave (barnave) si borxh. Për këtë kemi rekomanduar të pritët menjëherë praktika e marrjes së mallrave “borxh”, para se të lidhet kontrata ose marrja e mallrave pjesore nga furnizuesi me argumentimin se nuk e disponon të gjithë sasinë e barnave të caktuara në kontratë.

Për të parandaluar krijimin e detyrimeve të reja i rekomandojmë institucionit që të ndiqet praktika e pagesave të mallrave bazuar me datën e hyrjes së tyre në magazinë, gjithashtu asnjë likuidim nuk duhet të bëhet pa praktikën e plotë dokumentare dhe kontratën përkatëse.

Mbi zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në shoqëritë aksionere

Rezulton se KLSH gjatë veprimarisë audituese të ushtruar në Shoqëritë aksionere, ka evidentuar shkelje dhe mangesi si rrjedhojë e moszbatimit të ligjshmërisë me pasojë dëm ekonomik prej 8,1 miliardë lekë. Rezultatet e disa nga auditimeve kryesore janë:

Mbi auditimin e ushtruar në Albpetrol Sh.a

Nga auditimi i radhës në shoqërinë Albpetrol sha, u konstatua që kjo shoqëri ka funksionuar si një kompani shtetërore tërësisht në dobi të interesave të kompanive koncensionare private dhe interesave të drejtuesve më të lartë të saj, duke shmangur në mënyrë flagrante vendimmarrjen e Këshillit të Ministrave, Këshillit Mbikëqyrës, Drejtorisë së Auditit të Brendshëm dhe drejtorive të tjera të Albpetrol, si dhe duke krijuar e konsoliduar struktura paralele drejtuese në brendësi të shoqërisë. Më konkretisht, shkeljet kryesore që kanë rezultuar nga auditimi i Albpetrol janë:

- 1. Nënshkrimi me të njëjtën kompani koncensionare i dy akt-marrëveshje hidrokarbure, tërësisht në kundërshtim me procedurat e parashikuara ligjore dhe në tejkalim të plotë të kompetencave të Administratorit të Albpetrol Sh.a.;**
- 2. Shlyerja e detyrimit të Albpetrol ndaj shoqërive koncesionare, me dhënien e naftes direkt nga vendburimi, dhe jo nepermjet Qendrës së Administrimit dhe Shitjes së Naftës dhe Gazit në Patos;**
- 3. Zbritja nga nafta e prodhuar, e sasisë së holluesit të përdorur, veprime të cilat kanë shkaktuar uljen e padrejtë të detyrimeve që shoqëri koncesionare i kanë Albpetrol. Dëmi i shkaktuar rreth 7.2 milionë euro;**
- 4. Pasaktësi në llogaritje të bilancit të naftës së prodhuar, me efekte të mëdha financiare në rezultatin e shoqërisë;**
- 5. Krijimi i strukturave paralele për të dubluar veprimtarinë e Albpetrol sh.a, si në rastin e organizimit të Drejtorisë së Marrëveshje dhe Hidrokarbure. Nga 150 punonjës që është personeli i administratës së Albpetrol, 63 prej tyre i përkasin Drejtorisë së Marrëveshjeve dhe Hidrokarbureve;**
- 6. Probleme te mprehta sociale, të mbartura në vite, ne trajtimin e ish-punonjesve dhe punonjësve aktualë të Albpetrol Sh.a., te ngritura nga Sindikata e Nxjerrjes se Naftes.**

Çështjet dhe problematikat e mësipërme të trajtuara më hollësisht edhe në raportin e auditimit të Albpetrol sha, kërkojnë angazhimin dhe bashkëveprimin e një sërë institucioneve shtetërore, kryesisht Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Këshillit Mbikëqyrës të Albpetrol si dhe AKBN, por pavarësisht punës së këtyre institucioneve, mendojmë që **për problematikat disavjeçare të ngritura nga Sindikata e Nxjerrjes së Naftës, Patos dhe për të cilat kjo shoqatë i është drejtuar vazhdimisht institucioneve më të larta në vend, Kuvendi duhet të ndërmarrë nismën për të ngritur një komision të posaçëm parlamentar për shqyrtimin e tyre.**

Ne si KLSH kemi rekomanduar auditimin jo vetëm aktivitetin e shoqërisë por edhe kompanitë koncensionare, pa cënuar në asnjë rast në rrugë joligjore, të drejtat e këtyre kompanive. Vetëm pas kësaj, mendojmë se Kuvendi dhe opinioni i gjerë publik do të informohet me saktësi në lidhje me realitetin dhe përmasat e vërteta të këtij dëmi të konsiderueshëm, jo vetëm ekonomik, i cili është disa fish më tepër.

Dëmi ekonomik i zbuluar nga KLSH gjatë vitit 2013 është në vlerën 12,673.6 milionë lekë ose mbi 90.5 milionë euro dhe detyrimet debitoare në fund të vitit 2013 janë në total në vlerën 98,064 milionë lekë ose mbi 70 milionë dollarë. Më konkretisht:

I. Vlera e shkeljeve me dëm ekonomik në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit, në shumën 12,548 milionë lekë e detajuar paraqitet :

- Vlera e dëmit ekonomik në të ardhurat e buxhetit të shtetit në vlerën 3,901.2 milionë lekë
- Vlera e dëmit ekonomik në shpenzimet e buxhetit të shtetit në vlerën 665.9 milionë lekë
- Vlera e demit ekonomik te shkaktuar në shoqëritë anonime në total 8106.5milionë lekë nga e cila :

a) Vlera prej 5,566.8 milionë lekë e Albpetrol sh.a. Fier per mosarkëtim të ardhurash si pasojë e mosbatimit të detyrimeve kontraktore.

b) Vlera prej 2,242.8 milionë lekë e Autoritetit Portual Durres.

c) Vlera prej 296.9 milione lekë e demit ekonomik te evidentuar ne shoqëritë anonime në fushën e shpenzimeve.

Theksojmë se në dëmin ekonomik te evidentuar për Albpetrol Sh.a prej 5,566.8 milionë lekë nuk është përfshirë:


-Vlera e detyrimit prej 314.93 milionë lekë që përfaqëson dëmin ekonomik të shkaktuar nga kompania koncesionare B....(PPE&PPA) i përket vitit 2014.

-Vlera e detyrimit prej 5,374 milionë lekë që Shoqëria “Armo” sh.a. Fier, i ka shoqërisë “Albpetrol” sh.a Fier, që i përket detyrimit të vitit 2011.Për këtë vlerë KLSH ka kërkuar arkëtimin në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative të vlerës prej 5 374 .4 milionë që shoqëria “Armo”sh.a Fier, i ka shoqërisë “Albpetrol” sh.a Fier.Nga Alb Petrol Sha kërkesë padia ishte bërë për vlerën 1,949,693 mijë lekë por pas mbajtjes nga KLSH të procesverbalit datë 07.08.2014 , Albpetrol bëri kërkesë padi në datë 08.08.2014 në vlerën prej 3,424,756 mijë lekë.

II. Vlera e detyrimeve debitoare në shumën 98, 064 milionë lekë

Gjithsej (I+II) =110 737.6 milionë lekë.

Vlerat e mësipërme sipas fushave dhe sektorëve ku janë konstatuar paraqiten në aneksin nr. 2 bashkëlidhur këtij raporti.



Mbi auditimet e performancës

Gjatë periudhës, KLSH ka realizuar dhe evaduar 6 auditime performance, ka realizuar dhe dërguar në subjekte 5 projekt-raporte në pritje të observacioneve, si edhe ka inicijuar 4 auditime të reja. Ecuria e auditimeve të performancës ka ardhur në rritje, si në terma të cilësisë, ashtu edhe të sasisë. Rezultatet e disa auditimeve të rëndësishme të realizuara gjatë vitit 2013, përmendim:

Ndarja administrative-territoriale në Republikën e Shqipërisë

Auditimi tregoi se ndarja aktuale administrative – territoriale ka sjellë ngadalësim në zhvillimin vendor dhe vartësi të NJQV ndaj të ardhurave nga buxheti i shtetit. Shqipërisë i nevojitet ndarje e re administrative – territoriale duke u bazuar në kritere të qarta, me synim rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të NJQV në realizimin e objektivave për rritjen e shërbimeve në mënyrë sa më cilësore ndaj komunitetit. Bazuar në konstatimet tona kemi rekomanduar që realizimi i ndarjes së re territoriale administrative-tokësore të bazohet në ekonomicitetin, efikasitetin dhe efektivitetin e programeve qeveritare. Rekomandohet procesi i “bashkimit vullnetar”, por ndërkohë theksojmë se është shumë e nevojshme një marrëveshjeje ndërmjet forcave kryesore politike për të realizuar ribashkimin e NJQV me një kufi minimal prej 10.000 banorësh për Komuna dhe 15.000 banorësh për Bashki, duke negociuar dhe vendosur edhe kufijtë e rinj ndërmjet njësive të reja lokale.

Realizimi i ndarjes së re territoriale administrative-tokësore të bazohet në një studim të plotë nga Ministria e Çështjeve Vendore, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe ekspertë të fushës për ndarjen e re administrativo-territoriale, që të vazhdojë më pas me procedurat për hartimin dhe propozimin e projekt-ligjit të nevojshëm, duke respektuar Kushtetutën, dispozitat e ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore dhe Kartën e Autonomisë Vendore.

Censusi 2011

Auditimi tregoi pavarësisht punës së mirë në realizimin e objektivave kryesore dhe vështirësive të hasura nisur nga kompleksiteti i procesit të Census 2011, regjistrimi i popullsisë dhe i banesave nuk ka mbuluar të gjithë zonën e regjistrimit të RSH, si dhe nuk ka qenë i orientuar në përfaqësimin kosto-efektivitet. Nga auditimi ka rezultuar

- Mungesa e një analize paraprake të detajuar për të gjitha aktivitetet e procesit të Census, që në fazën e planifikimit për përcaktimin e kostos dhe burimet e financimit, ka çuar në rritjen e kostos totale të këtij procesi.
- Censusi nuk e ka përmbushur misionin e tij për pasqyrimin e nivelit të punësimit në vend, duke e bërë jo efektiv modulën përkatës të përfshirë në pyetësor.
- Për çështje me ndjeshmëri publike, sikurse është feja, regjistrimi i informacionit të bëhet rigorozisht. Kjo duke marrë shkas edhe nga pakënaqësitë apo kontestimet që mund të bëjnë me të drejtë komunitetet fetare.
- Ndryshe nga marzhi i gabimit të publikuar nga INSTAT në intervalin 3-5% popullsi e paregjistruar, KLSH vlerëson se mosregjistrimi shkon deri në nivelin 30% të popullsisë totale.

Shërbimi ushqimor spitalor

Auditimi tregoi se ofrimi i shërbimit të ushqimit në spitalet e qytetit të Tiranës lë të për dëshiruar në drejtim të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të tij.

- Kemi konstatuar se performanca e shërbimit të ushqimit, pra kontrolli cilësisë së ushqimit të servirur tek pacienti, nuk është bërë në asnjë nga spitalet publike të Tiranës, pasi nuk ekzistojnë mjetet e duhura për të realizuar kontrollin e cilësisë së ushqimit dhe as vullneti i spitaleve për të realizuar këtë kontroll.
- Në të gjitha spitalet, nuk ekzistonin kritere apo udhëzime formale për monitorimin e cilësisë, dhe megjithëse në kontratë, nuk ka klauzola për këto procedura, vihet re se ka pasur raportime për performancë jo të mirë nga kontraktori.
- Edhe pse QSUT-së, nuk i ka munguar eksperiencia e mëparshme për planifikimin e fondeve për ushqimin, ajo kishte planifikuar dhe llogaritur vlerën e kontratës vetëm për një vit dhe jo në shumën e plotë të pagueshme pa TVSH, për gjithë periudhën e zgjatjes së saj prej 7 vjetësh.

Në fund të këtij misioni kemi arritur në konkluzionin se zgjidhja e problematikës së hasur në spitalet tona në lidhje me planifikimin, çmimet e ndryshme të ushqimit të ofruar dhe zgjatja pafund e procedurave të prokurimit, do ishte Marrëveshja kuadër qëllimi i së cilës është të vendosë kushtet e kontratave, që do të prokurohen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe aty ku është e përshtatshme, me sasi të parashikuara.

Performanca e KESH sh.a, liberalizimi i tregut të energjisë elektrike (fazë project raporti)

Auditimi tregoi se ngarkimi me funksionin e prodhuesit publik të energjisë, garantimi i blerjes së energjisë së prodhuar nga HEC-et e dhëna me koncesion, si dhe ndërtimi i marrëdhënieve kontraktuale me çmime të rregulluara (të diktuar ose nga ERE, ose nga qeveria në marrëveshjet koncesionare), sigurimi i importit (blerjes) së energjisë elektrike për llogari të CEZ Shpërndarje (aktualisht OSHEE), jo vetëm që e kanë denatruar funksionin themelor të një shoqërie publike (sigurimin e fitimit dhe rritjen e efektivitetit), por e kanë zhytur atë në detyrime financiare ndaj klientëve, duke e bërë domosdoshmëri ndryshimin e mënyrës së funksionimit, administrimit dhe menaxhimit, nëpërmjet ndarjes së përgjegjësisë (prodhimi nga blerja: importi dhe/ose blerja e energjisë nga HEC-et e dhëna me koncesion), si dhe hapjen e tregut të energjisë elektrike, të cilat do të reflektohen në fund të fundit në cilësinë dhe koston e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve.

Kemi rekomanduar ndryshimin e modelit të tregut të energjisë elektrike në funksion të kalimit gradual në një treg të liberalizuar, me synim rritjen e konkurrencës; zhvillimin e një reforme tarifore me interes për mbrojtjen e konsumatorëve; mundësimin për ndërhyrje me strategji dhe politika afatgjata; integrimin e këtij tregu në Tregun Rajonal dhe atë Evropian të Energjisë Elektrike, duke siguruar qëndrueshmëri dhe shërbim cilësor në furnizimin me energji elektrike.

Ndarjen e Divizionit të Furnizimit Publik me Shumicë nga KESH sh.a, si strukturë më vete, duke e vendosur shoqërinë (KESH) si operator në treg në cilësinë e prodhuesit dhe tregtuesit të energjisë elektrike, duke bërë të mundur fuqizimin ekonomik dhe financiar të KESH ShA në

funkcion të rritjes së efektivitetit të përdorimit të burimeve hidrike në kaskadën e Drinit (e vetmja publike aktualisht); përmirësimi i teknologjisë ekzistuese dhe për pasojë uljen e kostos, si dhe mundësimin e burimeve të tjera për rritjen e prodhimit dhe diversifikimin e burimeve elektrike;

Në kushtet aktuale të modelit ekzistues të tregut dhe pozicionimit të operatorëve në këtë sistem, si edhe në perspektivën e ndryshimeve të mundshme, rekomandojmë ruajtjen e çmimeve aktuale të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë. Arsytet e mungesës së eficiencës në këtë sektor nuk kanë lidhje me çmimin, por mosarkëtimin dhe rregullat e tregut në përgjithësi. Po kështu, rritja e çmimit të energjisë penalizon konsumatorët korrektë dhe favorizon vjedhësit e energjisë, duke sjellë komplikime sociale. Rritja e çmimit rrit gjithashtu presionin inflacionist për ekonominë si të tërë, gërryen fuqinë blerëse dhe madje mund të shpjerë në rënie të ritmit të rritjes. Përfundimisht, rritja e çmimit të energjisë duhet të konsiderohet nga MEI si alternativë e fundit e përmirësimeve në këtë sektor dhe shoqërinë në përgjithësi; kjo pasi humbjet të jenë reduktuar në nivele të pranueshme, pasi tregu të jetë liberalizuar dhe konkurrenca të veprojë normalisht dhe pasi të jetë bërë një studim i plotë dhe i kujdesshëm i efekteve e risqeve në ekonomi dhe harmonizimit me politikën monetare, fiskale e sociale.

Sikurse është theksuar dhe në Deklaratën e Pekinit të Kongresit të 21-të të INTOSAI-t në tetor 2013, : *“Institucionet e auditimit të jashtëm publik, nëpërmjet auditimit të pavarur profesional të Buxhetit të Shtetit, mund të ndihmojnë ligjvënësit dhe vendimmarrësit e Qeverisë, për të ruajtur qëndrueshmërinë afatgjatë të politikave financiare, duke rritur transparencën, raportimin mbi performancën e financave publike, si dhe duke theksuar rreziqet sistematike”* (Deklarata e Pekinit, paragrafi 4).

Në frymën e masave për të zbutur pasojat e krizës botërore ekonomike dhe financiare, Deklarata e Pekinit kërkon nga institucionet e auditimit të jashtëm publik që të rrisin qëndrueshmërinë e financave publike të vendeve të tyre, duke:

- * *Vlerësuar supozimet e planifikimit qeverisës, në lidhje me ekonominë, financat publike dhe borxhin publik, duke identifikuar rreziqet potenciale dhe dhënë rekomandime konstruktive;*

- * *Rritur auditimin e përputhshmërisë me rregullat fiskale, me rregullimin financiar dhe standardet e pranueshme të mbikëqyrjes, si dhe duke mbikëqyrur të gjithë procesin buxhetor të qeverisë. Objektivi është sigurimi i llogaridhënies gjatë gjithë fazave të planifikimit, ekzekutimit dhe vlerësimit të performancës dhe rezultateve të arritura nga Buxheti.* “(Deklarata e Pekinit, paragrafi 1 dhe 2).

Në zbatim të ketyre orientimeve thelbësore të INTOSAI-t, Organizatat ndërkombëtare të institucioneve të auditimit të jashtëm publik, ne si KLSH jemi gati **te ndihmojmë në përgatitjen dhe zbatimin e Projekt-Buxhetit të vitit 2015, të ndergjegjshëm se mund të japim kontributin tonë modest në stabilitetin e politikave financiare publike dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.**

Ju faleminderit!